



Prishtinë: 19.12.2008.

Kodi i ZRRE-së: V\_151\_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_168\_12\_08

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_168\_12\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit Shaban Prapashtica (shifra e konsumatorit DPR – 90024680) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 14.10.2008 ka apeluar përgjigjen e departamentit për konsumatorë në KEK të datës 11.09.2008 lidhur me ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

- Me datë 13.12.2007, KEK-u ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik ku është hequr njehsori nr. 3127505 dhe është vendosur njehsori elektrik 40861417.  
**Provë:** Vërtetimi i njehsorit elektrik nr. 2259 të datës 13.12.2007
- Me datë 01.03.2008, qendra e kalibrimit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, por përreth qelqit është futur shiriti filmik ku është penguar puna e diskut.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 12/1 të datës 01.03.2008.
- Me datë 21.05.2008, ekipi i kontrollës së KEK-ut ka dalë në vendin e ngjarjes tek konsumatori dhe ka regjistruar gjendjen e pikës matëse dhe ka marrë profilin e kabllit furnizues.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 0141210 të datës 21.05.2008.
- Me datë 07.04.2008, KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar në vlerë prej 6,432.18 €.  
**Provë:** Fatura DPR08HP06146 e datës 07.04.2008.
- Me datë 21.08.2008, konsumatori ka parashtruar ankesë në departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit e datës 21.08.2008.



- Me datës 11.09.2008, departamenti për konsumatorë i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kalibrimit nr. 12/1 të datës 01.03.2008.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 11.09.2008.
- Me datë 15.09.2008, KEK-u ka lëshuar Urdhër Lejimi / Ngarkim nr. 17749 ku KEK-u korrigjon faturën e rikthimit të humbjeve në vlerë 838.98.  
**Provë:** Urdhër Lejim / Ngarkim nr. 17749 të datës 15.09.2008.
- Me datë 14.10.2008, konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatorit, ka vërejtur se:

- ✓ Organizata KCBS (Kosova Cluster & Business Support) në kuadër të USAID ka pasur me qira shtëpinë e konsumatorit të lartpërmendur që prej 30.11.2000 e deri më 15.10.2008. Në këtë shtëpi kanë qenë të instaluar 4 njehsorë.
- ✓ Njehsori nr. 3127505, ka regjistruar energjinë e konsumuar në katin përdhes me 40 m<sup>2</sup> (dy dhoma dhe një banjo) e shfrytëzuar kohë pas kohe për fjetje të konsulentëve që kanë qenë të angazhuar për kohë të shkurt.
- ✓ Nga momenti i marrjes me qira të shtëpisë nga KCBS, obligimet për pagesën e faturave i ka marrë KCBS.  
**Provë:** Kontrata KCBS – Pronari.
- ✓ Nga momenti i paraqitjes së kësaj kontrate në KEK, KEK-u e ka regjistruar në CCP si konsumator të këtij njehsori KCBS-në dhe i ka dërguar faturat në emër të KCBS; e njëjta i ka paguar faturat për këtë njehsor dhe për 3 njehsorë tjerë të vendosur në këtë shtëpi.
- ✓ Kjo shtëpi është shfrytëzuar për mbajtjen e mësimit të fakultetit filologjik, pa kompensim nga viti 1992 deri në 1998.  
**Provë:** Deklarata konsumatorit.
- ✓ Sipas analizave të bëra të rrjedhjes së energjisë aktive është vërejtur se me ndërrimin e njehsorit të ri konsumatori ka konsumuar më pak energji elektrike se sa me njehsor të vjetër dhe atë duke krahasuar rrjedhjen e energjisë në periudha të ndryshme.  
**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive.
- ✓ Sipas dokumentit të qendrës së kalibrimit theksohet se përreth qelqit është futur shiriti filmik me ç'rast është penguar puna e diskut; mirëpo kjo qendër nuk ka mund të përcaktoi kohën kur një abuzim i tillë ka mund të ndodhë. Me analizën e regjistrimit të energjisë së matur në njehsor për periudhën kur ky konsumator ka qenë shfrytëzues i kësaj pike matëse, nuk mund të vërehet ndonjë periudhë ku kemi ulje të energjisë së matur. Nëse një abuzim i tillë të kishte ndodhur në këtë periudhë atëherë ai do të vërehej në pasqyrat e rrjedhjes së energjisë aktive.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit.



**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura, e në veçanti ka marrë parasysh se këtë pikë matëse e ka shfrytëzuar një organizatë ndërkombëtare KCBS, me financim nga USAID (nuk ka ekzistuar asnjë motiv për abuzim ngase të gjitha shpenzimet për shërbime i ka bartë projekti i USAID-it) dhe gjithashtu duke marrë parasysh konsumin e pandryshuar të këtij konsumatori para dhe pas ndërrimit të njehsorit, ka vendosur ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së, sa i përket ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë për konsumatorin KCBS (USAID) për periudhën për të cilën ngarkohet.

Në bazë të proceseve të prezantuara nuk mund të përcaktohet koha se kur ka ndodhë abuzimi me njehsor, andaj një abuzim i tillë ka mund të ndodhë para se konsumatori (KCBS) të jetë shfrytëzues i kësaj pike matëse (para 30.11.2000, apo edhe para luftës).

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkojë konsumatorin nga fatura e ngarkuar për shfrytëzim të paautorizuar DPR08HP06146

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar